

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2021

QËNDRIMI ETIK NDAJ PACIENTËVE NË REPARTIN GJINEKOLOGJIK NË SPITALIN E PRIZRENIT

Mirseta Xhaferi

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Nursing Commons](#)

Recommended Citation

Xhaferi, Mirseta, "QËNDRIMI ETIK NDAJ PACIENTËVE NË REPARTIN GJINEKOLOGJIK NË SPITALIN E PRIZRENIT" (2021). *Theses and Dissertations*. 2603.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2603>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti i Infermierisë

**QËNDRIMI ETIK NDAJ PACIENTËVE NË REPARTIN
GJINEKOLOGJIK NË SPITALIN E PRIZRENIT**
Shkalla Bachelor

Mirseta Xhaferi

Prill/ 2021
Prizren



Kolegji UBT
Fakulteti i Infermierisë

Punim Diplome
Viti akademik 2017-2021

Mirseta Xhaferi

**QËNDRIMI ETIK NDAJ PACIENTËVE NË REPARTIN
GJINEKOLOGJIK NË SPITALIN E PRIZRENIT**

Mentori: Dr. Arianit Jakupi

Prill / 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Çështje të ndryshme etike të hasura në praktikën e përditshme të infermierisë marrin pak vëmendje nga studiuesit, por mund të prodhojnë një mjedis pune stresues për infermierët. Ky studim cilësor u krijua për të eksploruar çështjet etike me të cilat përballen infermierët në praktikën e tyre dhe për të identifikuar boshllëqet duke përdorur kornizën e kodit etik. Studimi u krye në spitalin e Prizrenit, në repartin gjinekologjik. U zhvilluan diskutime me punonjësit dhe ekipin e punës. Analiza e diskutimeve identifikoi tre tema, përkatësisht; përgjegjësia e kompromentuar profesionale ndaj pacientit, sjellja jo-bashkëpunuese e kolegëve dhe imazhi i dobët i një infermieri/je në shoqëri. Infermierët raportuan se ata nuk ishin në gjendje të vepronin plotësisht sipas kodit për shkak të shumë kufizimeve në praktikën klinike.

Arsyet e identifikuara nga të anketuarit ishin konflikti në procedurat e pranimit në spital të pacientëve, mungesa e ilaçeve, konflikti në dhënien pëlqimit, akuzat e rrema nga pacientët, çekuilibrimi i kujdesit, kujdesi i kompromentuar infermierior dhe mungesa e komoditeteve, pritjet e pacientit dhe barrierat kulturore. Për më tepër, ndonjëherë puna e dobët në ekip dhe ngarkesa e pabarabartë e punës të infermierit u shtuan sfidave në vendin e punës.

Me aq sa informacion kam ky është studimi i parë i këtij lloji, i cili specifikon çështjet etike në praktikën e infermierëve në repartin gjinekologjik në Spitalin e Prizrenit. Infermierët përgjithësisht ishin të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre etike, por hasnin probleme në praktikimin e tyre si pasojë e shumë pengesave dhe barrierave. Gjetjet e këtij studimi nuk mund të përgjithësohen për të gjithë ekipet e punës dhe për të gjithë repartet apo spitalet në Kosovë, por të dhënat e mbledhura japin sugjerime dhe shpjegime për vështirësitë me të cilat përballen shumë infermierë në vendin tonë gjatë punës së tyre të përditshme.

Fjalë kyçe: etik, pacientë, repart, gjinekologjik, Spital, Prizren, etj.

MIRËNJOHJE

Në radhë të parë dua të falënderoj familjen time, pa përkrahjen e së cilës nuk do të ishte i mundur shkollimi dhe karriera ime. Falënderoj nënën, babanë, vëllezërit dhe motrat që nuk u kursyen asnjëherë në mbështetjen e tyre ndaj meje.

Një falënderim i posaçëm i dedikohet mentorit tim Dr. Arianit Jakupi, i cili jo vetëm gjatë studimeve, por edhe gjatë këtij punimi të diplomës më dha mbështetje dhe inspirim për punë.

Një falënderim i sinqertë i dedikohet shoqërisë dhe kolegeve të mi, që më kanë bërë më të lehtë këtë periudhë të studimeve dhe qenë pranë meje çdo herë.

TABELA E PËRMBAJTJES:

ABSTRAKT	III
MIRËNJOHJE.....	IV
Lista e grafikëve	VII
Lista e tabelave.....	VIII
1. HYRJE.....	1
1.1 Diskutimi i problemit	2
1.2 Qëllimi i studimit	3
1.3 Hipotezat e studimit	3
1.4 Termat e studimit	4
KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS	5
2.1 Përkufizime mbi etikën	5
2.2 Teoria e etikës infermierore	6
2.3 Parimet e etikës	7
2.3.1 Parimi etik i bamirësisë	8
2.3.2 Parimi etik i mosfunksionimit	9
2.3.3 Parimi etik i respektimit të autonomisë	10
2.3.4 Parimi etik i drejtësisë shpërndarëse	11
2.4 Disa koncepte të drejtësisë	12
2.4.1 Gjykimi dhe praktika gjinekologjike e bazuar në përfitimin dhe autonominë	13
2.4.2 Gjykimi dhe praktika obstetrike e bazuar në përfitimin dhe autonominë	14
2.5 Koncepti etik i fetusit si pacient.....	15
2.6 Kodi ndërkombëtar i etikës për infermierët	15
2.6.1 Infermierët dhe njerëzit	16
2.6.2 Infermierët dhe praktika	16
2.6.3 Infermierët dhe profesioni	17
2.6.4 Infermierët dhe ekipi i punës	17
2.7 Standardet e praktikës infermierore	17
2.7.1 Standardet e praktikës infermierore mbi shëndetin maternal dhe të fëmijës.. ..	17
2.8 Shoqata e standardeve të praktikës në praktikën e infermierisë.....	18
2.9 Standardet e larta të Kodit Etik dhe Deontologjisë mjekësore.....	19

KAPITULLI III: METODOLOGJIA	22
KAPITULLI IV: QËNDRIMI ETIK NDAJ PACIENTËVE NË REPARTIN GJINEKOLOGJIK NË SPITALIN E PRIZRENIT	23
4.1 Të dhënat demografike të të anketuarve	23
4.2 Problematikat që lidhen me qëndrimin etik ndaj pacientëve në repartin gjinekologjik në Spitalin e Prizrenit.....	24
4.2.1 Përgjegjësia profesionale e kompromentuar ndaj pacientëve.....	25
4.2.2 Sjellja jo bashkëpunuese e stafit.....	29
4.2.3 Imazh i dobët i një infermieri në shoqëri.....	30
5. DISKUTIME	31
6. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	33
7. REFERENCAT	34

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Moshë dhe përvoja në punë.....**Error! Bookmark not defined.**

Lista e tabelave

Tabela 1: Analiza e procesit.....	24
-----------------------------------	----

1. HYRJE

Një çështje etike mund të lindë në çdo situatë të kujdesit shëndetësor kur pyetjet e thella morale të “së drejtës” ose “së gabuarës” qëndrojnë në themel të vendimmarrjes profesionale dhe kujdesit ndaj pacientëve.

Profesionistët shëndetësorë, veçanërisht infermierët, përballen me sfida etike në praktikën e tyre të përditshme pasi atyre u kërkohet të sigurojnë kujdes autonom dhe bashkëpunues për individë të të gjitha moshave, duke iu përmbajtur parimeve etike (Ulrich CM, Taylor C, Soeken K, O'Donnell P, Farrar A, Danis M & Grady C., 2010). Situata bëhet veçanërisht komplekse për infermierët që punojnë nën kufizime të mëdha të burimeve (Jafree Sara Rizvi, et al, 2015). Për më tepër për shkak të aspekteve demografike, sociale, shkencore dhe teknologjike të kujdesit shëndetësor, ka pasur një rritje të ndërlikueshmërisë së çështjeve etike me të cilat përballlet ofrimi i shërbimit të kujdesit shëndetësor (Bunch EH, 2002). Çështjet etike në praktikën e infermierisë tërheqin pak vëmendje, duke rezultuar në krijimin e ankthit moral, kujdesit të dobët profesional, joproduktivitetit dhe konfliktit.

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore i formuluar nga Oda e Mjekëve të Kosovës është përmirësuar dhe plotësuar në kuadër të përmirësimit, sipas vendimit të OMK-së në dhjetor të vitit 2019 (Oda e Mjekëve të Kosovës, 2019). Studimi aktual u ndërmor për të identifikuar aderimin e infermierëve në Kodin e Etikës Profesionale në Prizren, në repartin gjinekologjik, me një qëllim për të përmirësuar kujdesin ndaj pacientit. Ai gjithashtu eksploron çështjet etike me të cilat përballen infermierët në mjedisin e tyre klinik dhe mënyrën se si ata punojnë në raste të vështira. Studimi bazohet në fusha tematike që janë të brendshme për çdo takim klinik, përkatësisht: indikacionet mjekësore, preferencat e pacientëve, cilësia e jetës, karakteristikat kontekstuale, puna e ekipore dhe vlera e profesionit të infermierit. Këto çështje u rishikuan në dritën e kodit etik profesional, duke përfshirë përgjegjësinë profesionale në lidhje me pacientët dhe kolegët.

1.1 Diskutimi i problemit

Studimi i etikës kërkon të sigurojë mjetet apo mënyrat e formulimit të përgjigjeve për pyetjet dhe kështu shërben si një udhëzues veprimesh. Ajo siguron një strukturë apo kornizë e cila merret me çështjet, problemet dhe dilemat. Të kuptuarit e teorive etike ose morale ndihmon një person të vendosë mbi një linjë të duhur veprimet, megjithëse ajo nuk do t'i pajisë ata domosdoshmërisht me përgjigjet. Studimi i etikës, megjithëse në fillim mund të duket kryesisht teorike ka dhe aplikimin praktik.

Në rastin e studimit në fjalë, do të studiohet qëndrimi etik ndaj pacientëve në repartin gjinekologjik në Spitalin e Prizrenit, kjo për të dhënë një kuptim më të gjerë të etikës dhe rëndësisë së saj në profesionet që kanë të bëjnë me shëndetësinë. Ka mjaft raste kur natyra etike e problemit është shumë e qartë, si rasti i ndërprerjes së shtatëzanisë në rastet kur rrezikohet jeta e pacientes, ndërsa në raste të tjera si ato që lidhen me transplantin e organeve, fertilizimin in vitro, etj, janë gjithnjë tema të cilat shtrojnë pyetje etike, përgjigjet e të cilave nuk mund të gjenden lehtë në ndonjë kod tradicional të moralit.

Nëse një infermiere ka për detyrë të kujdeset për një paciente që i është nënshtruar abortit në mënyrë të paligjshme ose thjesht me vullnet të saj të plotë, ndërkohë që kjo infermiere është totalisht kundër abortit moralisht, a do të ndikonte kjo në kujdesin ndaj pacientes? Për infermierën, veçanërisht për mamitë ka një kontradiktë të fortë ndërmjet përgjegjësisë për të mbrojtur, ushqyer dhe siguruar jetën e fëmijës dhe përgjegjësinë për kujdesin ndaj gruas, për të cilën një shtatëzani e padëshiruar mund të jetë një shkatërrim personal. Detyra për tu kujdesur si për nënën ashtu dhe për fëmijën shpesh herë i vendos me shpatulla pas muri profesionistët shëndetësor në situatat kur është e pamundur të mos zgjedhin jetën e njerit. Dilema të tilla janë pjesë e punës së përditshme të infermierëve.

1.2 Qëllimi i studimit

Profesionistët shëndetësorë përballen me sfida etike në praktikën e tyre të përditshme, veçanërisht infermierët, forca më e madhe e punës në shëndetësi. Atyre u kërkohet të sigurojnë kujdes autonom dhe bashkëpunues për individë të të gjitha moshave, duke iu përmbajtur parimeve etike. Situata bëhet veçanërisht komplekse për infermierët që punojnë nën kufizime të mëdha të burimeve. Çështjet etike në praktikën e infermierisë tërheqin pak vëmendje, duke rezultuar në krijimin e ankthit moral, kujdesit të dobët profesional, joproduktivitetit dhe lindjes së konflikteve. Ky studim ka për qëllim hetimin e qëndrimit etik ndaj pacientëve në repartin gjinekologjik në Spitalin e Prizrenit, parë nga këndvështrimi i infermierëve.

Për të arritur këtë qëllim, ky studim ka këto objektiva:

- Të shqyrtohet koncepti i etikës, parimet, koncepti i drejtësisë, etj;
- Të analizohet kodi ndërkombëtar i etikës së infermierëve dhe Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;
- Të shqyrtohet qëndrimi etik ndaj pacientëve në repartin gjinekologjik në Spitalin e Prizrenit;
- Të evidentohen problematikat e zbatimit të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore në repartin gjinekologjik në Spitalin e Prizrenit.

1.3 Hipotezat e studimit

Hipoteza e përgjithshme e këtij studimi është: Qëndrimi etik ndaj pacientëve në repartin gjinekologjik në Spitalin e Prizrenit është i mbështetur mbi Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

1.4 Termat e studimit

- 1. Kodi i Etikës për Infermierët:** Kodi i Etikës për Infermierët përcakton qartë përgjegjësitë e infermierëve për fillimin dhe mbështetjen e masave për të plotësuar nevojat shëndetësore dhe sociale të publikut, në mënyrë të veçantë ato të pambrojtur. Roli i infermierit si një avokat për barazi dhe për drejtësi sociale shfaqet në drejtimin e shumë shoqatave kombëtare të infermierëve dhe ka shumë shembuj të profesionistëve të shëndetit që punojnë së bashku për të pasur një ndikim më të madh mbi politik-bërësit për përmirësimin e mundësive në këtë fushë. (Oda e Mjekëve të Kosovës, 2019)
- 2. Infermiera:** Infermiera përfshinë kujdesin autonom dhe bashkëpunues të individëve të të gjitha moshave, familjeve, grupeve dhe komuniteteve, të sëmurë apo të shëndoshë dhe në të gjitha mjediset. Infermiera përfshinë promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe kujdesin e të sëmurëve, të personave me aftësi të kufizuara dhe atyre në prag të vdekjes. Mbrojtja, promovimi i një mjedisi të sigurt, hulumtimi, pjesëmarrja dhe arsimim. (Oda e Mjekëve të Kosovës, 2019)

KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Përkufizime mbi etikën

Etika është studimi i disiplinuar i moralit. Morali ka të bëjë me dhe bindjet tona aktuale për ato standarte që duhet të plotësojë sjellja jonë.

Etika mjekësore është studimi i disiplinuar i moralit në mjekësi. Ajo ka të bëjë me detyrimet e mjekëve dhe organizatave të kujdesit shëndetësor ndaj pacientëve, si dhe detyrimet e pacientëve. Është e rëndësishme të mos ngatërrohet etika mjekësore me shumë burime të moralit në një shoqëri pluraliste. Këto përfshijnë ligjin, trashëgiminë politike, fetë në të gjithë botën, traditat etnike dhe kulturore, familjet, traditat dhe praktikatat e mjekësisë dhe përvojën personale. Etika mjekësore, që prej iluminizmit Evropian dhe Amerikan të shekullit XVIII, ka qenë laike. Ajo nuk i referohet Zotit ose traditës së zbuluar, por asaj që kërkon dhe prodhon ligjërimi racional.

Në të njëjtën kohë, etika laike mjekësore synon të mos jetë armiqësore në thelb, ndaj besimeve fetare. Kjo mund të jetë një sfidë e vërtetë në etikën e obstetrikës dhe mjekësisë riprodhuese. Në etikën mjekësore, parimet dhe virtytet etike duhet të kuptohen që të zbatohen për të gjithë mjekët, pavarësisht nga besimet e tyre personale fetare dhe shpirtërore. (Refatllari B., & Merkaj V., & Kurti F., 2015)

Në një këndvështrim shkencor, etika mjekësore është disiplina që studion tërësinë e normave të sjelljes dhe parimeve morale të punonjësve të shëndetësisë në disa drejtime:

- Në drejtim të marrëdhënieve të mjekut dhe infermierit me të sëmurët dhe të afërmit e tyre.
- Në drejtim të marrëdhënieve të mjekëve dhe të infermierëve ndërmjet tyre.
- Në drejtim të pastërtisë morale në jetën e përditshme të njeriut të shëndetësisë.

(Refatllari B., & Merkaj V., & Kurti F., 2015)

Etika mjekësore trajton parimet themelore në të cilat mbështeten këto marrëdhënie, si mirëbërësia, autonomia, drejtësia, të cilat përbëjnë skeletin mbi të cilin inserohen parimet e kësaj shkence shoqërore.

Parimet, rregullat, normat, vlerat shpesh përdoren si sinonime në vend të njëra-tjetrës.

Etika mjekësore tregon mënyrën se si profesionistët e shëndetit përmbushin detyrat e tyre dhe sigurojnë kujdesin ndaj pacientit. Etika mjekësore respekton jetën, shëndetin, dinjitetin e çdo pacienti, autonominë e tij të plotë në vendimarrje për problemet e shëndetit. Morali mjekësor nuk lejon shfrytëzimin e epërsisë së pozicionit të privilegjuar që ka profesionisti në mjekësi, në marrëdhënien me pacientin dhe familjarët e tij, për të përfituar moralisht dhe materialisht në mënyrë të padrejtë, të pamerituar, të paligjitime dhe abuzive. (Refatllari B., & Merkaj V., & Kurti F., 2015)

Detyra kryesore e ekipit mjekësor është të mbrojë jetën, shëndetin fizik dhe psikik të pacientit dhe të lehtësojë vuajtjen apo dhembjen. Në mosionin e tyre human për mbrojtjen e shëndetit, zbulimin dhe mjekimin e sëmundjeve, profesionistët e shëndetësisë bazohen në shkencën mjekësore dhe ndërgjegjen e tyre. Ata duhet të bëjnë çdo gjë që është në duart e tyre, për të respektuar dhe mbrojtur profesionin mjekësor duke demonstruar vazhdimisht një standard të lartë profesional dhe një sjellje etike të përshtatshme ndaj të sëmurit, familjarëve dhe ndaj çdo personi tjetër që kërkon ndihmë. (Refatllari B., & Merkaj V., & Kurti F., 2015)

2.2 Teoria e etikës infermierore

Nuk është e qartë nëse vetëm një teori e vetme infermierore mund të përshkruajë etikën infermierore dhe nëse vetëm një e tillë është e nevojshme. Megjithatë, nëse një teori e etikës infermierore mund të përshkruhet, ajo ka nevojë për shumë karakteristika. (Refatllari B., & Merkaj V., & Kurti F., 2015)

Së pari, ajo duhet të ketë në fokus mirëqënien humane, si një e mirë thelbësore e moralit. Infermiera është para së gjithash një praktikë, e cila kërkon mirëqënien humane duke promovuar shëndetin, parandaluar sëmundjet, rimëkëmbur shëndetin dhe lehtësuar dhimbjen. (International Council of Nurses, 2006) Infermierët kanë përgjegjësi primare profesionale ndaj njerëzve, të cilat kanë nevojë për kujdes infermieror dhe janë të detyruar të promovojnë mirëqënien e tyre, pavarësisht statusit të tyre shëndetësor.

Së dyti, një teori e etikës infermierore duhet ta verë theksin në përkujdesin si një detyrim moral. Shumë teoricienë të etikës infermierore tashmë kanë shpallur se kujdesi është një vlerë qendrore për dimensionet etike të praktikës infermierore (Gadow, S., 1985). Gadow (1985) argumenton se vlera e përkujdesjes mbështet etikën infermierore, e cila do të mbrojë dinjitetin human të pacientëve, të cilët marrin kujdes shëndetësor. Ajo e shikon përkujdesjen në marrëdhënien infermier-pacient si një detyrë deri në fund të jetë së pacientit. Përkujdesja nuk është vetëm themeli për praktikën infermierore, por ajo është e rëndësishme për të shkëlqyer, për të patur sukses në praktikë. Kujdesi i mirë përfshin përkujdesin ndaj dimensioneve shpirtërore, fizike, sociale, psikologjike, morale ndaj pacientit si komponentë qendrorë në marrëdhënien infermier-pacient. (Gadow, S., 1985)

Së treti, një teori e etikës infermierore duhet ta verë theksin në rëndësinë e karakteristikave të moralit në marrëdhëniet infermier-pacient. Një infermier, i cili është një person me moral të mirë, do të ketë dëshirën dhe motivimin të promovojë mirëqënien e pacientit. Një infermier i tillë ka më shumë gjasa që të kuptojë çfarë duhet të bëjë në rolin e tij si infermier, ka më shumë gjasa që të përformojë veprimet që i kërkohen dhe ka më shumë mundësi që të veprojë bazuar në idealet morale. (Beauchamp, T.L., & Childress, J.F., 2009)

Së katërti, një teori etike infermierore duhet të përfshijë parimet dhe normat etike, të cilat infermierët mund t'i përdorin për të justifikuar vendimet etike në praktikën infermierore. (Johnstone, M.J., 2004)

Studimet e këndvështrimeve të marrjes së vendimeve etike infermierore, të përdorura nga infermierët theksojnë se ata duhet të kombinojnë drejtimin me orientim parimor me drejtimin me orientimin përkujdesës ndaj pacientit. (Cooper, M.C., 1991)

2.3 Parimet e etikës

Etika është një dimension thelbësor i praktikës obstetrike dhe gjinekologjike. Etika parandaluese ndihmon për të ndërtuar dhe mbështetur një marrëdhënie të fortë mjek-pacient në praktikën e obstetrikës dhe gjinekologjisë. Komponentët kryesorë të kornizës etike janë përkufizimet e etikës dhe etikës mjekësore, si dhe shpjegimi i parimeve

themelore etike të etikës mjekësore, përfitimit dhe respektit për autonominë. Shqetësimi tjetër është se si këto dy parime duhet të ndërveprojnë në gjykimin dhe praktikën klinike gjinekologjike. Ato gjithashtu, duhet të ndërveprojnë në gjykimin dhe praktikën obstetrike, e cila thekson konceptin e fetusit si një pacient, i cili është unik për praktikën e obstetrikës. Ekzistojnë koncepte të ndryshme të parimeve etike të drejtësisë. Është e rëndësishme që çështjet etike të jenë përgjegjëse në menaxhimin e burimeve, duke theksuar virtytet e mjekut si profesionist.

2.3.1 Parimi etik i bamirësisë

Parimi etik i përfitimit në kuptimin dhe zbatimin e tij të përgjithshëm kërkon që dikush të veprojë në një mënyrë që pritet të prodhojë në mënyrë të besueshme, ekuilibrin më të madh të përfitimeve mbi dëmet në jetën e të tjerëve. Për të vendosur këtë parim në praktikën klinike kërkon një llogari të besueshme të përfitimeve dhe dëmeve që lidhen me kujdesin e pacientit dhe se si ato përfitime ose dëmtime duhet të ekuilibrohen në mënyrë të arsyeshme kundër njëri-tjetrit, kur jo të gjitha mund të arrihen në një klinikë. Janë situata të veçanta, si prsh. një kërkesë për një lindje cezariene. Në mjekësi, parimi etik i mirësisë kërkon që mjeku të veprojë në një mënyrë që pritet me besueshmëri, të prodhojë një ekuilibër më të madh të përfitimeve klinike mbi dëmet për pacientin.

Gjykimi klinik i bazuar në përfitime ka një origjinë antike në historinë e etikës mjekësore. Shprehja e parë e këtij parimi, në historinë e etikës mjekësore perëndimore, ndodh në Betimin e Hipokratit dhe në tekstet shoqëruese. Këto tekste bëjnë një pretendim të rëndësishëm: të interpretojë me besueshmëri, interesat e lidhura me shëndetin si dhe interesat e tjerë të pacientit nga një këndvështrim mjekësor. Kjo perspektivë sigurohet nga kërkimi i akumuluar mjekësor, përvoja klinike dhe përgjigjet e arsyetuara të pasigurisë. Mbi bazën e këtij këndvështrimi rigoroz klinik, i përqendruar në disponimin e provave më të mira, gjykimi klinik i bazuar në përfitime identifikon përfitimet klinike që mund të arrihen për pacientin në praktikën mjekësore bazuar në kompetencat e mjekësisë.

Përfitimet klinike që mjekësia është kompetente të kërkojë për pacientët, janë parandalimi dhe menaxhimi i sëmundjes, dëmtimit, paaftësisë dhe dhimbjes së

panevojshme, shqetësimit, vuajtjes, dhe parandalimi i vdekjes së parakohshme ose të panevojshme. Dhimbja, shqetësimi dhe vuajtja bëhen të panevojshme kur ato nuk rezultojnë në arritjen e përfitimeve të tjera të kujdesit mjekësor, si prsh. lejimi i një gruaje të lindë pa anestezi efektive.

2.3.2 Parimi etik i mosfunksionimit

Mosfunksionim do të thotë që mjeku duhet të parandalojë shkaktimin neto ose vetëm të dëmit klinik tek pacientët dhe kuptohet më së miri si shprehja e kufijve të përfitimit. Mosfunksionimi njihet gjithashtu si “Primum non nocere” ose “së pari mos bëni dëm”. Ky rregull zakonisht thekson dobinë duke shmangur dëmtimin kur afrohen kufijtë e ilaçeve. (Battie Renae, et al, 2014) Mosfunksionimi duhet të përfshihet në gjykimin klinik të bazuar në përfitim: kur mjeku i afrohet kufijve të gjykimit klinik të bazuar në përfitim, si prsh. kur provat për përfitimin e pritur klinik neto zvogëlohen dhe rreziqet e dëmit klinik rriten, atëherë mjeku duhet të vazhdojë me shumë kujdes. Mjeku duhet të shqetësohet veçanërisht për të parandaluar dëmtimin klinik serioz, të gjerë dhe të pakthyeshem të pacientit.

Përgjigja etike parandaluese ndaj paternalizmit është që mjeku të shpjegojë arsyetimin diagnostik, terapeutik dhe prognostik që çon në gjykimin e tij klinik në lidhje me atë që është në interesin e pacientit, në mënyrë që pacienti ta vlerësojë vetë atë gjykim. Ky rregull i përgjithshëm mund të vihet në praktikë klinike në mënyrën e mëposhtme: Mjeku duhet të zbulojë dhe t'i shpjegojë pacientit faktorët e spikatur klinikisht ose të rëndësishëm të këtij procesi arsyetimi, përfshirë çështjet e pasigurisë. (Gadow, S., 1985)

Një avantazh për mjekun në kryerjen e kësaj qasjeje për të komunikuar me pacientin besojmë se do të ishte, që të rritet mundësia e pajtueshmërisë. Kjo është një konsideratë veçanërisht e duhur në praktikën gjinekologjike, ku pacienti shpeshherë duhet të monitorojë veten për ndryshime klinike (si psh. një grua shtatzënë në rrezik), dhe të marrë një rol aktiv në mjekësinë parandaluese (si psh. vetëkontrolli i gjirit), si dhe në praktikën obstetrike (si psh. vetëkoll për shtim të pazakontë ose gjakderdhje). Një

avantazh tjetër do të ishte sigurimi i pacientit me një informacion më të detajuar në mënyrë që të marrë një vendim, ose nëse do të kërkojë një mendim të dytë.

2.3.3 Parimi etik i respektimit të autonomisë

Në ndryshim nga parimi i përfitimit, në literaturën e etikës mjekësore ka pasur theks të shtuar mbi parimin e respektimit të autonomisë. Në përgjithësi, ky parim etik kërkon që gjithnjë të pranohen dhe zbatohen preferencat e bazuara në vlera të një pacienti të rritur, përveç nëse ekziston një justifikim etik bindës për të mos bërë kështu, si psh. përshkrimin e antibiotikëve për infeksionet e frymëmarrjes virale. Pacientja femër, shtatzënë apo jo, gjithnjë e më shumë sjell në kujdesin mjekësor, perspektivën e saj për atë që është në interesin e saj. Parimi i respektimit të autonomisë e përkthen këtë fakt në gjykim klinik të bazuar në autonomi. Për shkak se perspektiva e çdo pacienti për interesat e tij është një funksion i vlerave dhe besimit, është e pamundur të specifikohen përfitimet dhe dëmet e gjyimit klinik paraprakisht të bazuar në autonomi. Në të vërtetë, do të ishte e papërshtatshme që mjeku ta bëjë këtë, sepse përcaktimi i përfitimeve dhe dëmeve si dhe balancimi i tyre janë e drejta e çdo pacienti. Në mënyrë që të kuptojmë kërkesat morale të parimit etik të respektimit të autonomisë, na duhet një koncept i funksionalizuar i autonomisë për ta bërë atë të rëndësishëm për praktikën klinike. Për ta bërë këtë, ne identifikojmë tre sjellje të bazuara në autonomi nga ana e pacientit:

1. Mbledhjen dhe mbajtjen e informacionit në lidhje me gjendjen dhe përgjigjet alternative diagnostike dhe terapeutike ndaj saj;
2. Kuptimi i informacionit (si psh. vlerësimin dhe renditjen e atyre përgjigjeve si dhe rreziqet që ajo mund të përjetojë gjatë trajtimit);
3. Shprehja e një preference të bazuar në vlerë. (Ulrich CM, Taylor C, Soeken K, O'Donnell P, Farrar A, Danis M & Grady C., 2010)

Mjeku ka një rol për të luajtur në secilën nga këto. Ata janë, përkatësisht:

1. Të njohë aftësinë e secilit pacient për t'u marrë me informacion mjekësor, të sigurojë informacion dhe të njohë vlefshmërinë e vlerave dhe besimeve të pacientit.

2. Të mos ndërhyjë por, kur është e nevojshme, të ndihmojë pacientin në vlerësimin dhe renditjen e alternativave diagnostike dhe terapeutike, për menaxhimin e gjendjes së tij;
3. Të nxjerrë dhe zbatojë preferencën e bazuar në vlerën e pacientit. (Illysa R. Foster, Jon Lasser, 2011)

Detyrimet ligjore të mjekut në lidhje me pëlqimin e informuar u vendosën në një seri rastesh gjatë fillimit të shekullit XX. Në 1914, *Schloendorff v. Shoqëria e Spitalit të Nju Jorkut*, vendosi konceptin e pëlqimit të thjeshtë, si psh. nëse pacienti i thotë “po” ose “jo” ndërhyrjes mjekësore. Deri më sot, në literaturën mjekësore dhe bioetike, citohet ky vendim: “Çdo qenie njerëzore në një moshë madhore dhe mendje të shëndoshë, ka të drejtë të përcaktojë se çfarë do të bëhet me trupin e tij, dhe një kirurg i cili kryen një operacion pa pëlqimin e pacientit të tij, kryen një sulm për të cilin ai është përgjegjës për dëmet”. (Battie Renae, et al, 2014)

Pëlqimi i thjeshtë bazohet në konceptin ligjor të batisë, ose prekje pa pëlqim.

2.3.4 Parimi etik i drejtësisë shpërndarëse

Konsiderohet si një lloj i drejtësisë, drejtësia shpërndarëse është një koncept qëndror që lidhet ngushtë me konceptet e dinjitetit njerëzor, të mirës së përbashkët dhe të drejtave të njeriut. Konsideruar si një parim etik, drejtësia shpërndarëse i referohet asaj që shoqëria ose një grup më i madh u detyrohet anëtarëve të saj individualë në proporcion me:

1. nevojat, kontributi dhe përgjegjësia e individit.
2. burimet në dispozicion të shoqërisë ose organizatës (konsideratat e tregut ose konsiderata të tjera financiare do të përfshihen nën këtë). si dhe
3. përgjegjësia e shoqërisë ose organizatës për të mirën e përgjithshme. (Gadow, S., 1985)

Në kontekstin e kujdesit shëndetësor, drejtësia shpërndarëse kërkon që të gjithë të kenë akses të barabartë në kujdesin shëndetësor bazë, të nevojshëm për të jetuar një jetë plotësisht njerëzore, përderisa ekziston një e drejtë themelore e njeriut në lidhje me këtë.

2.4 Disa koncepte të drejtësisë

Shqetësimet etike në lidhje me drejtësinë lindin kur burimet janë të pakta. Drejtësia kërkon që gjatë shpërndarjes së burimeve, secili të marrë atë që i takon. Koncepte të ndryshme të drejtësisë përcaktojnë “shkakun” në mënyra të ndryshme. Secili përpiqet të rezultojë në një shpërndarje të drejtë të përfitimeve, d.m.th. qasje në burime, barrierat dhe rreziqet që mund të pasojnë nga mungesa e një aksesit të tillë.

Utilitarizmi është një teori e drejtësisë që e bën thelbësor detyrimin për të prodhuar të mirën më të madhe për numrin më të madh në menaxhimin e burimeve të pakta. Për të qenë i suksesshëm në drejtimin e vendimeve praktike, të përditshme në lidhje me shpërndarjen e burimeve, utilitarizmi kërkon një llogari të së mirës më të madhe. Për shoqërinë në përgjithësi, ka qenë e vështirë, në mos e pamundur, të përcaktojë se cila është e mira më e madhe. (Gadow, S., 1985) Vlera e utilitarizmit është ekuilibri që kërkon të arrijë midis përfitimeve dhe ngarkesave të burimeve të pakta, në mënyrë që pabarazitë të mos bëhen pabarazi, d.m.th. të padrejta. Kritikët e utilitaristëve kanë theksuar se nganjëherë utilitarizmi rezulton në pabarazi, d.m.th. shpërndarje të përbashkët të përfitimeve dhe barrave.

Dy koncepte të tjera të drejtësisë janë zhvilluar për të adresuar këtë problem. I pari nga këto është një koncept libertarian i drejtësisë. Ky koncept i drejtësisë u zhvillua për të korrigjuar ngarkesat tiranike që mund të krijonin utilitarizmi i pastër. Gjithkush duhet të mbajë atë që ai ose ajo fiton përmes këtyre shkëmbimeve të tregut, duke reflektuar theksin e fortë të konceptit libertarian të drejtësisë mbi të drejtat e pronës (Illysa R. Foster, Jon Lasser, 2011). Teoritë libertariane theksojnë drejtësinë e procesit, sesa barazinë e rezultateve.

Koncepti tjetër i drejtësisë që është zhvilluar është një koncept barazitar i drejtësisë. Ky koncept u zhvillua për të mbrojtur anëtarët e cenueshëm dhe të disavantazuar të shoqërisë, të cilët mund të humbasin në një shpërndarje utilitare të burimeve të pakta. Ky koncept i drejtësisë korrigjon rezultate të padrejta në formën e ngarkesave të padrejta për ata që janë më pak të aftë të mbrojnë veten.

2.4.1 Gjykimi dhe praktika gjinekologjike e bazuar në përfitimin dhe autonominë

Gjykimet klinike të bazuara në përfitime dhe autonomi, në praktikën gjinekologjike zakonisht janë në harmoni. Ndonjëherë, gjykimet klinike që bazohen në përfitime dhe autonomi janë në konflikt në praktikën gjinekologjike. Në situata konflikti, as përfitimi, as respekti për autonominë automatikisht nuk duhet të konsiderohen mbizotëruese. Në vend të kësaj, të dy parimet etike fillimisht duhet të kuptohen si të peshuara teorikisht në mënyrë të barabartë (Mukherjee G., & Malhotra N., 2008). Kështu, ndryshimet e tyre duhet të negocohen në gjykimin dhe praktikën klinike. Kërkesat konkurruese të të dy parimeve duhet të jenë të ekuilibruara dhe të negociuara në rastin specifik klinik për të përcaktuar se cilat strategji të menaxhimit mbrojnë dhe promovojnë interesat e pacientit. Në gjuhën teknike të etikës, ne po i trajtojmë këto parime si *prima facie* ose potencialisht të tejkalueshme, mbi bazën e reflektimit dhe argumentit të kujdesshëm në mjedisin klinik.

Detyrimi etik dhe ligjor i mjekut në çështjen e refuzimit të informuar është shumë i qartë dhe nuk është i vështirë për t'u përmbushur. Në të gjitha rastet, pa përjashtim, pacienti duhet të informohet qartë për rreziqet mjekësore që po ndërmerret gjatë refuzimit të tij. Rreziqet që do të zbulohen janë ato që janë të dukshme në gjykimin klinik: nëse ato janë të rëndësishme për mjekun, domethënë motivojnë ofrimin ose rekomandimin e testit ose terapisë diagnostike, ato janë të dukshme. (Jafree Sara Rizvi, et al, 2015) Ky diskutim, veçanërisht rreziqet e refuzimit, duhet të dokumentohen plotësisht në dosjen e pacientit. Pacienti nuk ka pse të nënshkruajë këtë dosje hyrëse. Është detyrim i rreptë ligjor i mjekut, të sigurojë që zbulimi i rrezikut dhe dokumentacioni janë gjithëpërfshirës dhe të hollësishëm. Kjo është gjithçka që kërkon ligji. Etika parandaluese kërkon që ky zbulim të pasohet nga një rekomandim që pacienti të rishikojë refuzimin e tij. Kjo qasje etike-parandaluese shmang nevojën për të braktisur pacientin, mban linjat e komunikimit të hapura dhe i dërgon atij një sinjal të fuqishëm shqetësimi nga mjeku për marrëzinë mjekësore të refuzimit të tij.

Procesi i negociimit të konfliktit midis dy parimeve është një funksion i disa faktorëve të përfshirë në gjykimin klinik gjinekologjik: lënda; probabiliteti i përfitimit mjekësor;

disponueshmëria e alternativave të arsyeshme dhe aftësinë e pacientit për të marrë pjesë në procesin e miratimit të informuar. Kur lënda është kryesisht e natyrës teknike, siç është zgjedhja e një regjimi efektiv antibiotik ose teknika kirurgjikale intraoperative, gjykimi klinik bazohet në baza përfitimi. (Ulrich CM, Taylor C, Soeken K, O'Donnell P, Farrar A, Danis M & Grady C., 2010) Kjo është për shkak se çështjet teknike kryesisht kanë të bëjnë me përfitimet e bazuara në evidencë për grumbullimin e pacientëve me një plan të veçantë diagnoze dhe trajtimi.

Vendime të tilla janë me të drejtë brenda kompetencave të gjinekologut. Vlerat individuale dhe besimet e një pacienti të veçantë nuk mund të merren lehtë parasysh në këtë proces. Në të kundërt, kur vlerat dhe besimet themelore të pacientit janë në rrezik, si psh. puna ose trajtimi i infertilitetit ose abortit me zgjedhje, gjykimi klinik bazohet në mënyrë të arsyeshme në autonomi (Illysa R. Foster, Jon Lasser, 2011). Kjo sepse ndërhyrjet e veçanta diagnostike ose trajtuese mund të ndikojnë drejtpërdrejtë dhe negativisht në vlerat themelore dhe besimet e një pacienti të caktuar, një çështje që vetëm secili pacient individual mund të vendos. Vendime të tilla janë me të drejtë brenda fushës së veprimit të pacientit.

2.4.2 Gjykimi dhe praktika obstetrike e bazuar në përfitimin dhe autonominë

Parimet etike të përfitimit dhe respektit për autonominë luajnë një rol më kompleks në gjykimin dhe praktikën obstetrike, sesa ato në gjykimin dhe praktikën gjinekologjike. Ekzistojnë padyshim detyrime të bazuara në përfitime dhe në autonomi ndaj pacientit shtatzënë: perspektiva e mjekut mbi interesat e lidhura me shëndetin e gruas shtatzënë siguron bazën për detyrimet e bazuara në përfitime të mjekut ndaj saj, ndërsa perspektiva e saj për këto interesa siguron bazën për detyrimet e bazuara në autonominë e mjekut ndaj saj (Murray Sh., & McKinney E., 2018). Për shkak të një sistemi nervor qendror pamjaftueshëm të zhvilluar, fetusit nuk mund të thuhet se zotëron vlera dhe besime. Kështu, nuk ka asnjë bazë për të thënë që një fetus ka një perspektivë mbi interesat e tij. Prandaj nuk mund të ketë detyrime të bazuara në autonomi ndaj asnjë fetusit. Prandaj, gjuha e të drejtave të fetusit nuk ka asnjë kuptim, e për këtë arsye nuk ka asnjë zbatim për

fetusin në gjykimin dhe praktikën klinike obstetrike, pavarësisht popullaritetit të saj në diskursin publik dhe politik, në Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera. Natyrisht, mjeku ka një perspektivë mbi interesat e lidhura me shëndetin e fetusit dhe mjeku mund të ketë detyrime të bazuara në përfitime ndaj fetusit, por vetëm kur fetusi është pacient. Për shkak të rëndësisë së tij për gjykimin dhe praktikën klinike obstetrike, koncepti etik i fetusit si pacient kërkon një shqyrtim të hollësishëm.

2.5 Koncepti etik i fetusit si pacient

Koncepti etik i fetusit si pacient është thelbësor për gjykimin dhe praktikën klinike obstetrike. Zhvillimet në diagnozën dhe strategjitë e menaxhimit të fetusit për të optimizuar rezultatin e fetusit janë bërë gjerësisht të pranuar, duke inkurajuar zhvillimin e këtij koncepti.

Ky koncept ka një domethënie të konsiderueshme klinike sepse fetusi është një pacient. Këshillimi direktiv, që është rekomandimi i një forme të menaxhimit. Ndërsa këshillim jo drejtues është i përshtatshëm dhe realizohet duke ofruar por mos rekomanduar një formë të menaxhimit për përfitime fetale. Sidoqoftë, mund të ketë pasiguri nëse fetusi është apo jo pacient. Një qasje për zgjidhjen e kësaj pasigurie do të ishte të argumentosh se fetusi është ose jo një pacient në bazë të personalitetit, ose ndonjë formë tjetër të statusit të pavarur moral. (Bunch EH, 2002)

2.6 Kodi ndërkombëtar i etikës për infermierët

